



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

Nr. 1281/7 prot.

Datë 10.07.2023

**V E N D I M**  
**Nr. 581/2023**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar

Në mbledhjen e datës 10.07.2023 shqyrtoi kërkesën me:

**Objekt:** Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “ANBIM” SHPK në procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur – “Marrëveshje Kuadër – me disa operatorë ekonomikë – me afat 24 muaj” me Nr. REF-58631-02-10-2023, me objekt: Loti 1, “*Blerje detergjent, dezinfektant dhe aromatizues*” me fond limit **7,107,802** (shtatë milion e njëqind e shtatë mijë e tetëqind e dy) lekë (pa TVSH) **61,206** (gjashtëdhjetë e në mijë e dyqind e gjashtë) Euro pa TVSH. Kursi i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë datë 10.02.2023 është 116.13 lekë), parashikuar për tu zhvilluar në datën 15.03.2023 nga autoriteti kontraktor, Agjencia Shtetërore e Prokurimeve të Përqendruara.

**Ankimues:** Operatori Ekonomik “ANBIM” SHPK.  
Adresa: Autostrada TR-DR KM. 1, Tiranë

**Autoriteti Kontraktor:** Agjencia Shtetërore e Prokurimeve të Përqendruara  
Adresa: Blv. “Dëshmorët e Kombit”, Nd. 1, 1001, Tiranë

**Baza Ligjore:** Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin

*e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.*

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

## **V ë r e n:**

### **I**

#### *Vlerësimi paraprak*

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Operatori ekonomik ankimues ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

### **II**

#### *Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 13.02.2023, është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “Procedurë e Hapur – “Marrëveshje Kuadër – me disa operatorë ekonomikë – me afat 24 muaj” me Nr. REF-58631-02-10-2023, me objekt: Loti 1, “Blerje detergjent, dezinfektant dhe aromatizues” me fond limit **7,107,802** (shtatë milion e njëqind e shtatë mijë e tetëqind e dy) lekë (pa TVSH) **61,206** (gjashtëdhjetë e në mijë e dyqind e gjashtë) Euro pa TVSH. Kursi i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë datë 10.02.2023 është 116.13 lekë), parashikuar për tu zhvilluar në datën 15.03.2023 nga autoriteti kontraktor, Agjencia Shtetërore e Prokurimeve të Përqendruara.

II.2. Më datë 15.03.2023, autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit objekt-shqyrtimi.

II.3. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor dhe sistemit prokurimeve elektronike rezulton se më datë 10.05.2023 autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1.	“EURO MEGA 2010” SHPK	3,616,700 lekë	skualifikuar
2.	“ANBIM” SHPK	3,685,045 lekë	skualifikuar
3.	“I&V COMPANY” SHPK	4,697,500 lekë	kualifikuar
4.	“SOLID GROUP” SHPK	4,753,800 lekë	skualifikuar
5.	“EGIAN MED” SHPK	5,200,000 lekë	kualifikuar
6.	“Malfina Visoka” P.F	5,207,700 lekë	kualifikuar
7.	“GET KLIN” SHPK	5,350,000 lekë	kualifikuar
8.	“ALBSOLUTION” SHPK	5,622,882 lekë	skualifikuar
9.	“ATLANTIK 3” SHPK	6,406,500 lekë	kualifikuar
10.	“Enea Masllavica” P.F	6,606,000 lekë	skualifikuar

II.4. Në datën 10.05.2023 operatori ekonomik “ANBIM” SHPK, është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave, si dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi, me argumentet si më poshtë vijon:

*“OE nuk i është përgjigjur letrës të dërguar nga KVO me nr prot 653 dt 03.05.2023 për argumentimin e ofertës anomalisht të ulët”.*

II.5. Në datën 16.05.2023 autoriteti kontraktor ka kryer rivlersimin e procedurës së prokurimit dhe ka njoftuar operatorët ekonomikë mbi rezultatet e rivlerësimit si më poshtë:

1.	“EURO MEGA 2010” SHPK	3,616,700 lekë	skualifikuar
2.	“ANBIM” SHPK	3,685,045 lekë	skualifikuar
3.	“I&V COMPANY” SHPK	4,697,500 lekë	kualifikuar
4.	“SOLID GROUP” SHPK	4,753,800 lekë	skualifikuar
5.	“EGIAN MED” SHPK	5,200,000 lekë	kualifikuar
6.	“Malfina Visoka” P.F	5,207,700 lekë	kualifikuar
7.	“GET KLIN” SHPK	5,350,000 lekë	kualifikuar
8.	“ALBSOLUTION” SHPK	5,622,882 lekë	skualifikuar
9.	“ATLANTIK 3” SHPK	6,406,500 lekë	kualifikuar
10.	“Enea Masllavica” P.F	6,606,000 lekë	skualifikuar

II.6. Në datën 10.05.2023 operatori ekonomik “ANBIM” SHPK, është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave, si dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi, me argumentet si më poshtë vijon:

*“OE nuk i është përgjigjur letrës të dërguar nga KVO me nr prot 653 dt 03.05.2023 për argumentimin e ofertës anomalisht të ulët”.*

II.7. Në datën 17.05.2023 autoriteti kontraktor ka kryer rivlersimin e procedurës së prokurimit dhe ka njoftuar operatorët ekonomikë mbi rezultatet e rivlerësimit si më poshtë:

1.	“EURO MEGA 2010” SHPK	3,616,700 lekë	skualifikuar
2.	“ANBIM” SHPK	3,685,045 lekë	skualifikuar
3.	“I&V COMPANY” SHPK	4,697,500 lekë	kualifikuar
4.	“SOLID GROUP” SHPK	4,753,800 lekë	skualifikuar
5.	“EGIAN MED” SHPK	5,200,000 lekë	kualifikuar
6.	“Malfina Visoka” P.F	5,207,700 lekë	kualifikuar
7.	“GET KLIN” SHPK	5,350,000 lekë	kualifikuar
8.	“ALBSOLUTION” SHPK	5,622,882 lekë	skualifikuar
9.	“ATLANTIK 3” SHPK	6,406,500 lekë	kualifikuar
10.	“Enea Masllavica” P.F	6,606,000 lekë	skualifikuar

II.8. Në datën 17.05.2023 operatori ekonomik “ANBIM” SHPK, është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave, si dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi, me argumentet si më poshtë vijon:

*“Nga shqyrtimi i dokumentacionit të këtij operatori ekonomik rezulton se:*

*-Operatori ekonomik nuk plotëson kërkesat e Nenit 93 të ligjit nr.162/2020 e këtij operatori pasi nuk arriti të argumentojë ofertën anomalisht të ulët , pasi dokumentacioni i paraqitur ka mangësi thelbësore në plotësimin e kushteve të kërkuara nga legjislacioni a) anën ekonomike të procesit të prodhimit, të mallrave të ofruara ose të metodës së ndërtimit; dhe c) origjinalitetin e punës, furnizimeve ose shërbimeve të propozuara nga ofertuesi;*

*Në shkresën e paraqitur me Lëndë ”INFORMACION” operatori ekonomik ka paraqitur ne forme narrative shpjegime e veta duke referuar kushtet e percaktuara ne Nenin 93 te LPP për:*

*a) anën ekonomike të procesit të prodhimit, të mallrave të ofruara ose të metodës së ndërtimit;*

*b) zgjidhjet teknike të përzgjedhura dhe/ose ndonjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm që ka ofertuesi për furnizimin e produkteve ;*

*c) origjinalitetin e punës, furnizimeve ose shërbimeve të propozuara nga ofertuesi;*

*ç) pajtueshmërinë me detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fushën e mjedisit, në fushën sociale dhe të punës;*

*d) mundësinë e ofertuesit për të marrë ndihmë shtetërore.*

*Për kushtin e parë a) anën ekonomike të procesit të prodhimit, të mallrave të ofruara ose të metodës së ndërtimit; operatori ekonomik shprehet se është prodhues i sapunit tualet larje duarsh dhe detergjentëve liquid si ËC dysheme, zbardhues rrobash hipoklorit natriumi, , amabalzh plastik ,prodh dhe aerosole automatike .*

*Konstatojme qe nga ana dokumentare Operatori Ekonomik per te vertëuar anën ekonomike të procesit të prodhimit të mallrave të ofruara operatori ka paraqitur :*

*1.Disa fotografi me pamje makineri prodhimi.*

*2.Një tabelë me zërat e kostove të detergjenteve me vlerat perkaste*

*Nisur nga keto dokumente dhe shpjegime e dhëna KVO vleron se ANBIM sh.p.k nuk ka arritur të argumentojë cmimet e ofruara sipas kushtit a) anën ekonomike të procesit të prodhimit, të mallrave të ofruara ose të metodës së ndërtimit; pasi nuk ka paraqitur:*

*Së pari , nuk është argumentuar dhe dokumentuar ana ekonomike e procesit të prodhimit referuar kostove të deklaruara, nuk ka asnjë shpjegim ekonomik si argumentohen keto kosto të deklaruara, nuk asnjë referencë si dhe ku sigurohen lëndët e para, nuk ka zëbërthim të kostove të fuqisë puntore dhe kosto direkte*

*Së dyti për kushtin c) origjinalitetin e punës, furnizimeve ose shërbimeve të propozuara nga ofertuesi; mungojnë faturat e blerjes së lëndëve të para nga furnizuesit, mungojnë certifikatat e cilësisë dhe analizat laboratorike të produkteve të deklaruara se prodhohen nga subjekti “Detergjent në formë të lenget “ mostra të ndryshme të këtyre produkteve shoqëruar me etiketat përkatse sipas ligjit Nr. 10 216, datë 21.1.2010 “Për detergjentët”.*

*Së treti, referuar dokumentacionit të paraqitur nuk ka asnjë të dhënë se ku janë vendosur linjat e prodhimit të deklaruara pasi në QKB nuk u gjet asnjë adresë e subjektit ku ushton aktivitetin e prodhimit të detergjentëve por ka vetëm një adresë për zyrat e operatorit ekonomik Rruga Naim Frasheri Pall60/1 shk1 AP3 Tirane;*

*Për sa më sipër, mbështetur në dokumentet administruara, përcaktimet në DST dhe në mbështetje të Nenit 93 pika 2 të ligjit të ligjit nr.162/2020, dhe arsyetimin e parashtruar më sipër, KVO në mënyrë përfundimtare vlerëson se operatori ekonomik nuk e ka argumentuar ofertën anomalisht të ulët dhe vendos të mos e pranojë ofertën e subjektit ANBIM sh.p.k.”.*

II.9. Në datë 25.05.2023 autoriteti kontraktor ka kryer publikimin e Njoftimit të Fituesit në sistemin e prokurimit elektronik (SPE).

II.10. Në datën 05.06.2023 pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me nr. 1281 prot., e operatorit ekonomik “ANBIM” SHPK, ka paraqitur ankesë njëkohësisht pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor duke kundërshtuar vendimin e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me skualifikimin e ofertës së tij ekonomike, në procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

II.11. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit Nr. 1281/2 prot., datë 06.06.2023 lidhur me arsyet e skualifikimit të operatorit ekonomik ankimues “ANBIM” SHPK, për të cilat ngrihen pretendime.

II.12. Në datën 06.06.2023 operatorit ekonomik “ANBIM” SHPK ka dërguar shkresën me objekt “Formular Ankese” protokolluar me tonën me nr. 1281/3 prot., datë 06.06.2023 ku ka dërguar bashkalidhur informacion në lidhje me argumentimin e ofertës anomalisht të ulët.

II.13. Me shkresën nr. 804/5 prot., datë 14.06.2023, protokolluar me tonën me nr. 1281/4 prot., datë 19.06.2023 me objekt *“Dërgim dokumentacioni për procedurën e prokurimit me objekt: “Blerje materiale pastrimi ndarë në 2 Lote” për Loti 1.”* është depozituar nga autoriteti kontraktor në Komisionin e Prokurimit Publik, akti mbi trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues *“ANBIM” SHPK*, lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit, ku rezulton se i ka kthyer përgjigje operatorit ekonomik ankimues duke vendosur mospranimin e ankesës për arsye se nuk ka plotësuar kushtet formale të ankesës.

II.14. Me qëllim verifikimin e mëtejshëm në lidhje me pagesën e tarifës financiare , KPP ju drejtua me memon nr. 1281/5 datë 10.07.2023 Drejtorisë së Monitorimit, Shërbimeve Mbështetëse dhe Financës pranë KPP për informacion mbi pagesën e tarifës financiare të kryer nga operatori ekonomik *“ANBIM” SHPK* për procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

II.15. Me memon nr. 1281/6 prot., datë 10.07.2023 Drejtoria e Monitorimit, Shërbimeve Mbështetëse dhe Financës informon se: *“Referuar memos nr. 1281/5 prot., datë 10.07.2023 Kërkesë në lidhje me dokumentin bankar, që vërteton pagesën e tarifës përkatëse për ankesën për ankim në një procedurë prokurimi, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, u krye dhe një verifikim tjetër me raportin e ardhur me email nga Dega e Thesarit për derdhjet e muajt Qershor dhe rezulton që është kryer pagesë nga operatori “Anbim” shpk në favor të komisionit të prokurimit Publik në vlerën prej 35,539 lekë me statusin e valuduar.”*, duke provuar se operatori ekonomik ka plotësuar kushtet formale të ankesës.

### **III**

#### **Komisioni i Prokurimit Publik**

pas shqyrtimit të ankesave, dokumentacionit bashkëngjitur tyre,

#### **Arsyeton**

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues *“ANBIM” SHPK*, mbi kundërshtimin e skualifikimit të ofertës së paraqitur prej tij, në procedurën e prokurimit objekt-shqyrtimi me arsyen : *Nga shqyrtimi i dokumentacionit të këtij operatori ekonomik rezulton se:*

*-Operatori ekonomik nuk plotëson kërkesat e Nenit 93 të ligjit nr.162/2020 e këtij operatori pasi nuk arriti të argumentojë ofetën anomalisht të ulët , pasi dokumentacioni i paraqitur ka mangësi thelbësore në plotësimin e kushteve të kërkuara nga legjislacioni a) anën ekonomike të procesit të prodhimit, të mallrave të ofruara ose të metodës së ndërtimit; dhe c) origjinalitetin e punës, furnizimeve ose shërbimeve të propozuara nga ofertuesi;*

*Në shkresën e paraqitur me Lëndë “INFORMACION” operatori ekonomik ka paraqitur në formë narrative shpjegime e veta duke referuar kushtet e percaktuara ne Nenin 93 te LPP për:*

- a) anën ekonomike të procesit të prodhimit, të mallrave të ofruara ose të metodës së ndërtimit;
- b) zgjidhjet teknike të përzgjedhura dhe/ose ndonjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm që ka ofertuesi për furnizimin e produkteve ;
- c) origjinalitetin e punës, furnizimeve ose shërbimeve të propozuara nga ofertuesi;
- ç) pajtueshmërinë me detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fushën e mjedisit, në fushën sociale dhe të punës;
- d) mundësinë e ofertuesit për të marrë ndihmë shtetërore.

Për kushtin e parë a) anën ekonomike të procesit të prodhimit, të mallrave të ofruara ose të metodës së ndërtimit; operatori ekonomik shprehet se është prodhues i sapunit tualet larje duarsh dhe detergjenteve liquid si ËC dysheme, zbardhues rrobash hipoklorit natriumi, , amabalzh plastik ,prodh dhe aerosole automatike .

Konstatojme qe nga ana dokumentare Operatori Ekonomik per te vertëuar anën ekonomike të procesit të prodhimit të mallrave të ofruara operatori ka paraqitur :

1.Disa fotografi me pamje makineri prodhimi.

2.Një tabele me zërat e kostove te detergjenteve me vlerat perkaste

Nisur nga keto dokumente dhe shpjegime e dhëna KVO vlerson se ANBIM sh.p.k nuk ka arritur të argumëtojë cmimet e ofruara sipas kushtit a) anën ekonomike të procesit të prodhimit, të mallrave të ofruara ose të metodës së ndërtimit; pasi nuk ka paraqitur:

Së pari , nuk është argumentuar dhe dokumentuar ana ekonomike e procesit te prodhimit referuar kostove te deklaruar, nuk ka asnjë shpjegim ekonomik si argumentohen keto kosto te deklaruar, nuk asnje referncë si dhe ku sigurohen lëndët e para, nuk ka zbërthim të kostove të fuqisë puntore dhe kosto direkte

Së dyti për kushtin c) origjinalitetin e punës, furnizimeve ose shërbimeve të propozuara nga ofertuesi; mungojne faturat e blerjes së lëndëve të para nga furnizuesit, mungojnë certifikatat e cilësisë dhe analizat laboratike të produkteve të deklaruar se prodhohen nga subjekti “Detergjent ne forme te lenget “ mostra të ndryshme të këtyre produkteve shoqëruar me etiketat përkatse sipas ligjit Nr. 10 216, datë 21.1.2010 “Për detergjente”.

Së treti, referuar dokumentacionit të paraqitur nuk ka asnjë të dhënë se ku janë vendosur linjat e prodhimit të deklaruar pasi në QKB nuk u gjet asnjë adresë e subjektit ku ushton aktivitetin e prodhimit te detergjentev por ka vetëm një adresë për zyrat e operatorit ekonomik Rruga Naim Frasheri Pall60/1 shk1 AP3 Tirane;

Për sa më sipër, mbështetur në dokumentet administruara, përcaktimet në DST dhe në mbështetje të Nenit 93 pika 2 të ligjit të ligjit nr.162/2020, dhe arsyetimin e parashtruar më sipër, KVO në mënyrë përfundimtare vlerëson se operatori ekonomik nuk e ka argumentuar ofertën anomalisht të ulët dhe vendos të mos e pranojë ofertën e subjektit ANBIM sh.p.k.”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor dorëzuar pranë KPP-së me shkresën protokolluar me tonën me nr. 1281/4 datë 19.06.2023, si dhe nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektornike, rezulton se KVO gjatë procesit të shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertave në aplikim të formulës mbi ofertën anomalisht të ulët ka konstatuar, se oferta e shoqërisë “ANBIM” është në kushtet e ofertës anomalisht të ulët. Në këto kushte KVO

nëpërmjet seksionit kërkesa të sistemit të prokurimeve elektronike, i është drejtuar operatorit ekonomik me kërkesë për sqarim/argumentim oferte anomalisht të ulët sipas nenit 93 të LPP-së.

Gjithashtu KVO me anë të shkresës me nr. 653 prot., datë 03.05.2023 me objekt “Kërkesë për informacion, në lidhje me ofertën anomalisht të ulët”, i është drejtuar operatorit ekonomik me kërkesë për sqarim/argumentim oferte anomalisht të ulët sipas nenit 93 të LPP-së.

III.1.2. Në përgjigje të kërkesës së KVO më datë 07.05.2023 operatori ekonomik “ANBIM” me qëllim justifikimin/argumentimin e ofertës anomalisht të ulët ka paraqitur në mënyrë elektronike dokumentacionin si më poshtë:

- Shkresën me lëndë Informacion duke pasqyruar një tabelë me zërat e kostos së detergjentëve.
- Fotografji me pamje të makinerive të prodhimit.
- Faturë shitje nr. 67/2023 datë 30.03.2023
- Faturë shitje nr. 76/2023 datë 13.04.2023
- Faturë shitje nr. 17/2021 datë 21.12.2021
- Faturë shitje nr. 9/2021 datë 01.11.2021
- Faturë shitje nr. 77/2023 datë 15.04.2023
- Faturë shitje nr. 50/2023 datë 13.03.2023
- Faturë shitje nr. 53/2023 datë 21.03.2023
- Faturë shitje nr. 197/2022 datë 16.12.2022
- Faturë shitje nr. 10/2021 datë 04.11.2021

III.1.3. Në nenin 93 pika 1 dhe 2 të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” përcaktohet se:  
“1. Kur autoritetet ose entet kontraktore vërejnë se oferta për punët, furnizimet ose shërbimet është anomalisht e ulët, i kërkon operatorit ekonomik të paraqesë me shkrim dhe brenda tri ditëve pune shpjegime për çmimin ose kostot e propozuara në ofertë.

2. Shpjegimet e përmendura në pikën 1 jepen veçanërisht për:

- a) anën ekonomike të procesit të prodhimit, të shërbimeve të ofruara ose të metodës së ndërtimit;
- b) zgjidhjet teknike të përzgjedhura dhe/ose ndonjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm që ka ofertuesi për furnizimin e produkteve ose shërbimeve ose për kryerjen e punës;
- c) origjinalitetin e punës, furnizimeve ose shërbimeve të propozuara nga ofertuesi;
- ç) pajtueshmërinë me detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fushën e mjedisit, në fushën sociale dhe të punës;
- d) mundësinë e ofertuesit për të marrë ndihmë shtetërore.

3. Autoriteti ose enti kontraktor vlerëson informacionin e dhënë, duke u konsultuar me ofertuesin. Ai mund ta refuzojë ofertën kur, edhe pas shqyrtimit të provave të dhëna nga ofertuesi, nuk bindet se ajo është e rregullt në të gjitha elementet e saj [...]”

III.1.4. Në nenin 82 “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave” të VKM Nr.285 datë 19.05.2021 Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, i ndryshuar parashikohet shprehimisht se:



*Pas korrigjimit të gabimeve aritmetike, komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon nëse ofertat e vlefshme janë ose jo me çmim anomalisht të ulët sipas formulës së përcaktuar në dokumentet standarde të tenderit. Përlllogaritja e ofertës anomalisht të ulët bëhet në mënyrat e mëposhtme:*

- *Në rastin kur janë të vlefshme dy ose më pak oferta, në përputhje me nenin 93, të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët kur ajo është ulur më shumë se 25% e fondit limit të përlllogaritur;*
- *Në rastin kur janë të vlefshme tri ose më shumë oferta, në përputhje me nenin 93, të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët nëse vlera e saj do të jetë më e vogël se 85% e mesatares së ofertave të vlefshme.*
- *Nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, komisioni i vlerësimit të ofertave duhet të kërkojë sqarime nga ofertuesit, përpara se të marrë vendim për kualifikimin ose jo të tyre, në përputhje me nenin 93, të LPP-së.*
- *Në çdo rast, ofertuesi ka detyrimin të argumentojë dhe të dokumentojë me prova shkresore, sqarimet për elementin/elementet e veçanta të ofertës, në përputhje me kërkesat e nenit 93, të LPP-së.*

III.1.5. Nga shqyrtimi i ofertës ekonomike të operatorit ekonomik “ANBIM” SHPK, si edhe nga përlllogaritjet e kryera, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton, se oferta ekonomike në vlerën prej **3,685,045** lekë pa TVSh , në zbatim të dispozitave ligjore të sipërcituara, rezulton anomalisht e ulët. Komisioni i Prokurimit Publik thekson faktin, që shpjegimet e operatorëve ekonomik për ofertën anomalisht të ulët duhet të lidhen me kushtet e përcaktuara në pikën 2 të nenit 93 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, nga ku katër kushtet e para janë të natyrës kumulative, në kuptimin që ato duhet të plotësohen njëkohësisht dhe në këtë vështrim, mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që operatori ekonomik të dështojë në argumentimin mbi paraqitjen e ofertës anomalisht të ulët, ndërsa kushti i pestë lidhet me *mundësinë* e ofertuesit për të marrë ndihmë shtetërore çfarë do të thotë, që jo çdo ofertues mund ta sigurojë këtë ndihmë dhe si rrjedhojë në ato raste kur ajo nuk është e mundur të sigurohet, mosplotësimi i këtij kushti nuk përbën shkak për dështimin e operatorit në argumentimin e ofertës anomalisht të ulët, nëse operatori ekonomik ofertues ka arritur të argumentojë/provojë me dokumente shkresore plotësimin e katër kushteve të para kumulative të përcaktuara në shkronjat “a”, “b”, “c” “ç” të pikës 2 të nenit 93 të *lex specialis*.

Në interpretim literal të nenit 93 pika 1 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se barra e provës mbi argumentin e ofertës anomalisht të ulët i përket operatorit ekonomik, oferta e të cilit është konstatuar nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave si anomalisht e ulët. Gjithashtu, KPP gjykon se argumentimi i ofertës anomalisht të ulët njëherazi duhet të plotësojë katër kushte kumulative për ti dhënë garanci si edhe bindje autoritetit kontraktor, se operatori ekonomik do të përmbushë me sukses kontratën. Së pari, operatori ekonomik ankimes duhet të dorëzojë në mënyrë të detajuar anën ekonomike të metodës së ndërtimit, procesit të prodhimit ose të shërbimeve të ofruara, gjithashtu duhet të paraqesë para autoritetit kontraktor zgjidhjet teknike të përzgjedhura dhe/ose ndonjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm që ka ofertuesi për furnizimin e produkteve ose shërbimeve, ose për kryerjen e punës. Gjithashtu është detyrë e operatorëve ekonomikë oferta e të cilëve është konstatuar anomalisht e ulët të paraqesin prova shkresore para autoritetit kontraktor në lidhje me origjinalitetin e punës, furnizimeve ose shërbimeve të

propozuara nga ofertuesi. Ata duhet të vërtetojnë pajtueshmërinë me detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fushën e mjedisit, në fushën sociale dhe të punës, në vendin ku do të kryhet puna, shërbimi apo ku do të sigurohet furnizimi si edhe së fundmi të argumentojnë apo provojnë *mundësinë* e tyre për të përfituar ndihmë shtetërore. Referuar nenit 93 pika 3 të LPP-së autoriteti kontraktor i verifikon këto elemente duke u këshilluar me ofertuesin dhe në bazë të informacionit të paraqitur. Autoriteti kontraktor mund ta refuzojë ofertën, kur edhe pas shqyrtimit të informacionit të paraqitur nga ofertuesi, nuk bindet se ajo është e rregullt në të gjitha elementet e saj. KPP gjykon se nga interpretimi teleologjik i normës së mësipërme (qëllimi i saj) lidhet drejtpërdrejtë me shmangien e riskut që mund të sjellë një ofertë e cila rezulton anomalisht e ulët. KPP gjykon se risku që shfaqet në rast se një ofertë rezulton anomalisht e ulët është në disa drejtime, ndër të tjera si: rreziku për moskryerjen e shërbimit/punëve në cilësinë e duhur; rreziku i tërheqjes së operatorit ekonomik nga lidhja e kontratës dhe kostot që i lindin autoritetit nga moskryerja e shërbimit brenda afateve kohore të parashikuara; humbjet që mund të pësojë në kohë nga moskryerja e shërbimit gjatë periudhës së ripublikimit të procedurës së tenderit në rast të moszbatimit të kontratës nga ana e operatorit ekonomik oferta e të cilit rezulton anomalisht e ulët. Gjithashtu, KPP thekson se referuar nenit 2 gërma “b” “Qëllimi” i ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet se; “*Qëllimi i këtij ligji është: b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale*”. Mirëpërdorimi i fondeve publike përfshin jo vetëm përzgjedhjen nga autoriteti kontraktor të ofertave më të ulëta (si kriter i përzgjedhjes së ofertës fituese referuar “çmimit më të ulët”), por gjithashtu shmangien e risqeve dhe dështimin e kontratës, që mund të vijë nga oferta të cilësuar si anomalisht të ulëta, referuar formulës së përlllogaritjes të parashikuar në ligj. Sa më sipër, referuar rastit në fjalë dhe themelit të kërkimit të operatorit ekonomik ankimes, KPP gjykon vetëm mbi dokumentet e dorëzuara pranë autoritetit kontraktor dhe në rast se këto të fundit përmbushin në mënyrë të detyrueshme katër kushtet e para kumulative të parashikuara nga neni 93 pika 2 i LPP-së, si dhe *mundësinë* për të përmbushur kushtin e pestë, mospërmbushja e të cilit nuk përbën shkak për dështimin e operatorit ekonomik në argumentimin e ofertës anomalisht të ulët.

III.1.6. Nga shqyrtimi në tërësi i dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik “ANBIM” SHPK, në mbështetje të ofertës anomalisht të ulët të paraqitur në procedurën e mësipërme të prokurimit, rezulton, se ky i fundit nuk është konform kërkesave të përcaktuara në ligjin dhe rregullat e prokurimit publik. Konkretisht, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton, se operatori ekonomik “ANBIM” SHPK, ka paraqitur si dokumentacion mbështetës ose provues: argumentimin e ofertës në mënyrë narrative përmes shkresës së datës 07.05.2023 me lëndë “Informacion”. KPP gjykon se, ankimesi përveç argumentimit të vet në formën e një narrative nuk ka ndarë qartë mënyrën se si e ka ndërtuar ofertën gjithashtu nuk ka paraqitur argumente për të gjithë zërat e parashikuar në preventivin e publikuar nga ana e autoritetit kontraktor në dokumentet e tenderit, nuk ka paraqitur prova shkresore për elementet e ofertës sikurse kërkuar, pranë autoritetit kontraktor e konkretisht nuk ka paraqitur asnjë dokument për zbarthimin e anës ekonomike të metodës së ndërtimit, një nga komponentët e rëndësishëm të nenit 93 të LPP. Referuar argumentimit të ofertës anomalisht të ulët por edhe në parashtrimet në ankesë ankimesi në asnjë pikë nuk i referohet përmbushjes së gërmës a) të nenit 93 të LPP ku flitet për anën ekonomike të **metodës së ndërtimit dhe paraqitjes së analizës së kostos për të gjithë elementët**. Operatori ekonomik ka detyrimin

të paraqesi të detajuar analizën e kostos së zërave në trajtë analitike, pra të argumentojë me prova dhe fakte dhe si dhe të të justifikojë çmimin e ofertuar për cdo zë.

Komisioni i Prokurimit Publik, sqaron se një parashikim i tillë gjen mbështetje edhe në Direktivën 24/2014 KE “Për prokurimin publik”, ku në nenin 69 të saj, parashikohen edhe kushtet për pranimin e ofertës anomalisht të ulët, në kuadër të zhvillimit të procedurave të prokurimit publik. Konkretisht, në nenin 69 të saj parashikohet se: “ Kur autoritetet kontraktore vërejnë se ofertat në lidhje me punët, furnizimet ose shërbimet janë anomalisht të ulëta, u kërkojnë operatorëve ekonomikë që të shpjegojnë çmimin ose kostot e propozuara në ofertë.

Shpjegimet e përmendura në paragrafin 1, jepen veçanërisht për:

**(a) anën ekonomike të procesit të prodhimit, të shërbimeve të ofruara ose të metodës së ndërtimit;**

(b) zgjidhjet teknike të përzgjedhura dhe/ose ndonjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm që ka ofertuesi për furnizimin e produkteve ose shërbimeve ose për kryerjen e punës;

(c) origjinalitetin e punës, furnizimeve ose shërbimeve të propozuara nga ofertuesi;

(d) pajtueshmërinë me detyrimet e përmendura në nenin 18, paragrafi 2;

(e) pajtueshmërinë me detyrimet e përmendura në nenin 71;

(f) mundësinë e ofertuesit për të marrë ndihmë shtetërore.

Në rastin konkret, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se nga ana e operatorit ekonomik ankimues nuk është dorëzuar asnjë dokumentacion i mjaftueshëm mbi metodën e ndërtimit të ofertës ekonomike mbi të cilën edhe operatori ekonomik ka ofertuar në procedurën e prokurimit objekt ankimi duke mos përmbushur kështu një nga kushtet e rëndësishme kumulative të parashikuara nga neni 93 i LPP-së. KPP gjykon se ankimuesi nuk ka paraqitur **analizë kostojë** të detajuar që të argumentojë kushtet apo elementet, pse kjo ofertë e dalë anomalisht e ulët duhet të pranohet dhe se nuk krijon asnjë rrezik për mosrealizimin me sukses të kontratës. KPP gjykon se shpjegimi narrativ përmes shkresës së datës 07.05.2023, dhe faturat e paraqitura nuk janë prova të mjaftueshme në kuptim të dispozitave ligjore në fuqi, si dhe nuk mjaftojnë për krijimin e bindjes, se ankimuesi disponon kapacitetet e nevojshme për realizimin e kontratës objekt-prokurimi.

Sa më sipër, KPP gjykon se shpjegimi narrativ dhe dokumentacioni shoqërues i paraqitur nga ankimuesi për argumentimin e ofertës anomalisht të ulët nuk janë prova të mjaftueshme në funksion të argumentimit të: *anës ekonomike të procesit të prodhimit, të shërbimeve të ofruara ose të metodës së ndërtimit*; metodës së përzgjedhur, zgjidhjeve teknike të posaçme, apo origjinaliteti i shërbimit të propozuar. Argumentim i dhënë nga ofertuesi në rastin konkret nuk krijon bindjen se kjo ofertë është e rregullt në të gjitha elementet e saj, me qëllim garantimin e një kontrate të suksesshme.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “ANBIM” SHPK nuk qëndron.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30 pika 1, 115 pika 1 dhe 3 si dhe neni 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023 “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së

*pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë komisionit të prokurimit publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,*

### **Vendos**

1. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “ANBIM” SHPK për procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur – “Marrëveshje Kuadër – me disa operatorë ekonomikë – me afat 24 muaj” me Nr. REF-58631-02-10-2023, me objekt: Loti 1, “Blerje detergjent, dezinfektant dhe aromatizues” me fond limit **7,107,802** (shtatë milion e njëqind e shtatë mijë e tetëqind e dy) lekë (pa TVSH) **61,206** (gjashtëdhjetë e në mijë e dyqind e gjashtë) Euro pa TVSH. Kursi i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë datë 10.02.2023 është 116.13 lekë), parashikuar për tu zhvilluar në datën 15.03.2023 nga autoriteti kontraktor, Agjencia Shtetërore e Prokurimeve të Përqendruara.
2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
3. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet përkatëse për derdhjen në Buxhetin e Shtetit të tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “ANBIM” SHPK.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

### **KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Nënkryetar**  
**Fiorent Zguro**

**Anëtar**  
**Kreshnik Ternova**

**Kryetar**  
**Jonaid Myzyri**